



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

Nr. 1038 Prot

Shkodër, më 16.01.2026

Lënda: Dërgohet projekt- vendim dhe relacion

**KËSHILLIT BASHKIAK, SHKODËR**

**Të nderuar këshilltarë,**

Bashkëngjitur ju dërgojmë për kompetencë shqyrtimi projekt-vendimin dhe relacionin:

Për një ndryshim në VKB nr 18 dt 20.07.2023 “Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore “Pruemos Sheldi”, Njësia Administrative Guri Zi, Fshati Sheldi, ngastra 104, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 12 muaj për shoqërine “Volitalia Albanie” i ndryshuar

*Duke ju uruar punë të mbarë.*

Me respekt,

**KRYETAR**

**Benet BECI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. 1038 / prot  
11

Datë 16 / 01 / 2026

PROJEKT VENDIM

NR. \_\_\_\_\_, DATË \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2026

PËR

NJË NDRYSHIM NË VKB NR 18 DT 20.07.2023 “PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA/PËRDORIM, TË SIPERFAQES 0.3201ha NË EKONOMIN PYJORE “PRUEMOS SHELDI”, NGA STRA 104, NJA GURI ZI, FSHATI SHELDI, PËR AKTIVITETIN INSTALIM TË SHTYLLËS ERËMATESE PËR STUDIMIN E ERËS, AEROGJENERATORE, PËR NJË PERIUDH 12 MUAJ PËR SHOQËRINË “VOLTALIA ALBANIE” I NDRYSHUAR

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja ‘e/1’ të ligji nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr.57/2020 “Për pyjet”, i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”, VKM nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, i ndryshuar; VKM nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit Ministrave “Për transferimin në pronesi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, të ndryshuar; dhe sipas relacionit të Drejtorisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave nr \_\_\_\_\_ prot, datë \_\_\_\_\_

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Shkodër nr.18, datë 20.07.2023 të ndryshuar, si më poshtë:  
Në paragrafin e fundit të pikës 1, ndryshohet shprehja mbi afatin nga “për një periudhë 24 muaj” bëhet “për një periudhë 36 muaj”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.




KRYETAR

BENET BECI


Zv.Kryetar

---


Drejtoria e Mjedisit dhe Energjisë Së Rinovueshme



Drejtoria e Pergjithshme Juridike, Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Mbeshtetese



Drejtoria Juridike





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

Nr \_\_\_\_\_ prot

Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2026

**RELACION**

**Për një ndryshim në VKB nr 18 dt 20.07.2023 “Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore “PrueMos Sheldi”, Njësia Administrative Guri Zi, Fshati Sheldi, ngastra 104, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 12 muaj për shoqërine “Votalia Albanie”. i ndryshuar**

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Shkodër  
Të nderuar këshilltarë,

Këshilli i Bashkisë Shkodër me Vendim nr 18 dt 23.07.2023 miratoi dhënie me qira të ekonomisë pyjore “PrueMos Sheldi”, Njësia Administrative Guri Zi, Fshati Sheldi, ngastra 104, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 12 muaj për shoqërine “Votalia Albanie” për të cilin me VKB nr 70 dt 12.11.2024 është bërë ndryshimi i periudhës së shfrytëzimit të sipërfaqes së dhënë me qira nga 12 muaj në 24 muaj.

Kompania “Votalia Albanie”i është drejtuar Bashkisë Shkodër ( administruar pranë bashkisë me nr 396 prot dt 08.01.2026 ) me kërkesën për shtyrjen e afatit edhe me 12 muaj të tjerë , kjo për arsye se “nuk kanë përfunduar ende mbledhjen e plotë të dhënave të nevojshme për një studim teknik”

Nisur nga sa më sipër në mënyrë që të realizohet qëllimi për të cilën është dhënë miratimi , pra për të bërë matjet nëse zona është e përshtatëshme për prodhim enegjie nga era, kërkojmë ndryshimin e paragrafit të fundit të pikës 1 të Vendimit te Keshillit te Bashkise nr 18 dt 20.07.2023 i ndryshuarb nga “për një periudhë 24 muaj”në “për një periudhë 36 muaj”

Bazuar në ligjin nr 57/2020 “Për pyjet“,VKM 559 datë 29.07.2022 “ Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore, kërkojmë ndryshimin e e paragrafit të fundit të pikës 1 të Vendimit te Keshillit te Bashkise nr 18 dt 20.07.2023 të ndryshuar nga “për një periudhë 24 muaj”në “për një periudhë 36 muaj”

Duke ju falenderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

**KRYETAR**  
**Benet BECI**


Me Vendim Delegimi

ZV Kryetar  
Alban PREKA



**Drejtoria e Mjedisit dhe Energjisë së Rinovueshme**

**Aida Shllaku**



To: Mr. Benet BECI  
Mayor, Shkodër Municipality

Z. Benet BECI  
Kryetar i Bashkisë Shkoder

From: Kelly CLUTTERBUCK  
Country Manager  
Volta Albania SHPK  
ETC Building, Blvd. Bajram Curri, 14<sup>th</sup> Floor,  
Tirana, Albania

Nga: Kelly CLUTTERBUCK  
Menaxhere e Vendit  
Volta Albania SHPK  
Ndërtesa ETC, Blvd. Bajram Curri, Kati 14,  
Tiranë, Shqipëri

Tirana, 06 January 2026

Tiranë, 06 Janar 2026

Prot. 04 No.

Nr. 04 Prot.

Ref.: Request for Extension of Lease Contract

Lënda.: Kërkesë për Shtyrje të Kontratës së Qirasë

Dear Mr. Beci,

I nderuar Z. Beci,

Thank you for the cooperation demonstrated by your institution. We kindly request a 12-month extension to the deadline of lease contract Prot. 18399 No., dated November 30, 2023, which was amended by amendment Prot. 2174/1 dated February 3, 2024, for the lease of 0.320 ha of land in the forest economy "Pruemos Sheldi," plot 104, Nj.A Guri Zi, village Sheldi, for the installation of the met mast pole for wind study and wind turbines.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e treguar nga institucioni juaj. Ju lutemi të na miratoni një zgjatje prej 12 muajsh të afatit të kontratës së qirasë Prot. 18399 Nr., datë 30 Nëntor 2023, e cila është ndryshuar me amendamentin Prot. 2174/1 datë 03/02/2024, për qiranë e 0.320 ha tokë në ekonominë pyjore "Pruemos Sheldi," parcela 104, Nj.A Guri Zi, fshati Sheldi, për instalimin e shtyllës met mast për studimin e erës dhe turbinave me erë.

The reason for this request is that, due to technical issues with the installed equipment caused by adverse weather conditions, we have not yet completed the full wind data collection necessary for the technical studies of the project.

Arsyeja e kësaj kërkesë është se, për shkak të problemeve teknike me pajisjet e instaluar si pasojë e kushteve atmosferike, nuk kemi përfunduar ende mbledhjen e plotë të të dhënave të erës, të nevojshme për përfundimin e studimeve teknike të projektit.

We appreciate your understanding and look forward to a positive response regarding this request.

Shpresojmë në mirëkuptimin tuaj dhe presim një përgjigje pozitive lidhur me këtë kërkesë.

Thank you in advance for your consideration.

Duke ju falënderuar paraprakisht për konsideratën tuaj.

Yours faithfully/Me respekt,

Kelly Clutterbuck  
Kelly CLUTTERBUCK

